

DEVOLL HYDROPOWER SH.A
Raporti i Auditorit të Pavarur
dhe Pasqyrat Financiare
për periudhën nga 18 dhjetor 2008 (data fillimit)
deri më 31 dhjetor 2008.

PËRMBAJTJA

	Faqe
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	3
PASQYRAT FINANCIARE:	
BILANCI KONTABËL	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	7
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	8-12

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionerëve dhe drejtimit të DEVOLL HYDROPOWER SH.A:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të DEVOLL HYDROPOWER SH.A ("Shoqëria"), të cilat përmbajnë bilancin kontabël më 31 dhjetor 2008, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të parasë për periudhën 18 dhjetor 2008 deri më 31 dhjetor 2008, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Pergjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa pasaktësira materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimet; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël të cilat janë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Pergjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojme siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësira materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut për pasaktësira materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi riskun, auditori konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi të përshatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektetivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin dhe përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëngjitur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2008, rezultatin financiar dhe fluksin e parasë për periudhën nga 18 dhjetor 2008 (data fillimit) deri më 31 dhjetor 2008 në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

DELOITTE ALBANIA sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
30 prill 2009

DEVOLL HYDROPOWER SH.A

Bilanci kontabël më 31 dhjetor 2008

(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2008
Aktivet		
I. Aktivet afatshkurtra		
1. Mjete monetare dhe ekuivalente	4	2,049,670
2. Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim		-
3. Inventari		-
4. Parapagime dhe shpenzime të shtyra		-
5. Aktive të tjera financiare afatshkurtra		-
Totali aktiveve afatshkurtra (I)		<u>2,049,670</u>
II. Aktivet afatgjata		
1. Investime financiare afatgjata		-
2. Aktive afatgjata materiale		-
3. Aktivet afatgjata jomateriale		-
4. Aktive të tjera afatgjata		-
6. Kapital i nënshkruar i papaguar	4	-
Totali aktiveve afatgjata		<u>2,049,670</u>
Totali aktiveve (I + II)		<u>2,049,670</u>
Detyrimet dhe kapitali		
I. Detyrimet afatshkurtra		
1. Hua afatshkurtra		-
2. Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet		4,967
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		<u>4,967</u>
II. Detyrimet afatgjata		
1. Hua afatgjata		-
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		-
Totali i detyrimeve (I + II)		<u>4,967</u>
III. Kapitali		
1. Kapitali aksionar	4	2,000,000
2. Fitim (humbja) e akumuluar		-
3. Fitim (humbja) e vitit		44,703
Totali i kapitalit (III)		<u>2,044,703</u>
Totali detyrimeve dhe i kapitalit aksionar (I,II,III)		<u>2,049,670</u>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve i DEVOLL HYDROPOWER SH.A më 30 Prill 2009

Olav Holland



Drejtore

Helwig Überacker



Drejtore

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënime shpjeguese në faqet 8 deri 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare:

DEVOLL HYDROPOWER SH.A**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën nga 18 dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 dhjetor 2008***(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Shënime	Për periudhën nga 18 dhjetor 2008 (data fillimit) deri më 31 dhjetor 2008
1. Shitjet	-
2. Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proçes.	-
3. Shpenzime për materiale dhe shërbime	-
4. Kosto personeli	-
- Pagat e personelit	-
- Kontributet shoqërore dhe shëndetsore	-
5. Zhvlersimi dhe amortizimi	-
6. Shpenzime të tjera	-
7. Totali i shpenzimeve (2-6)	-
8. Fitimi (humbja) nga veprimtaria kryesore (1+7)	-
9. Fitimi dhe humbja financiare	-
9.1. Fitim (humbja) nga kurset e këmbimit	49,670
9.2. Fitim (humbje) të tjera financiare	-
10. Total financial profit and loss (9.1+/-9.2)	49,670
11. Fitimi para tatimit (8+/-9)	49,670
12. Tatim fitimi	(4,967)
13. Fitimi neto për periudhën (11+12)	44,703

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

DEVOLL HYDROPOWER SH.A**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për periudhën
nga 18 dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 dhjetor 2008***(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Fitimi i mbartur	Totali
Më 18 dhjetor 2008 (data e fillimit)			
Rritja në kapitalin aksionar	2,000,000	-	2,000,000
Fitimi i vitit	-	44,703	44,703
Më 31 dhjetor 2008	2,000,000	44,703	2,044,703

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

DEVOLL HYDROPOWER SH.A**Pasqyra e fluksit të parasë për periudhën****nga 18 Dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 Dhjetor 2008***(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Shënime	Për periudhën nga 18 dhjetor 2008 (data fillimit) deri më 31 dhjetor 2008
I. Fluksi i parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit	44,703
Fitimi (humbja) para tatimit	-
Rregullime për:	-
Zhvleresimin dhe Amortizimin	-
Nxjerrje jashtë përdorimi e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara	-
Humbje nga këmbimet valutore	-
Shpenzime tatim fitimi	-
Të ardhurat nga interesi	-
(Rritja)/zvogëlimi në tepricën e kërkesave të arkëtueshme	-
(Rritja)/zvogëlimi në tepricën e inventarit	-
Rritja/(zvogëlimi) në tepricën e detyrimeve për tu paguar	4,967
Fluksi i parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit	49,670
Tatim fitimi i paguar	-
Interesa të arketuar	-
Fluksi neto i parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit	49,670
II. Flukse monetare nga veprimtaritë e investimit	-
Blerja e aktiveve të qëndrueshme	-
Te ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme	-
Fluksi neto i parasë nga veprimtaritë e investimit	-
III. Fluksi i parasë nga veprimtaritë e financimit	-
Kapital i paguar	2,000,000
Fluksi neto i parasë nga veprimtaritë e financimit	-
IV. Rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalente	2,049,670
V. Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të periudhës	-
VI. Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të periudhës	2,049,670

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 deri 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

DEVOLL HYDROPOWER SH.A

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 18 dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 dhjetor 2008

(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. HYRJJE

DEVOLL HYDROPOWER SH.A (më poshtë referuar si "Shoqëria") u themelua në përputhje me vendimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nr. SN-041249-12-08, datë 18 dhjetor 2008.

Shoqëria është krijuar për të ndërtuar tre sisteme për prodhimin e energjisë me një kapacitet prodhues prej 319 MW të vendosur në lumin Devoll, me vendndodhje 95 deri në 806 metra mbi nivelin e detit. Shoqëria do të merret edhe me shitjen e energjisë elektrike të prodhuar, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Përfaqesuesit ligjorë të Shoqërisë janë Z. Olav Holland dhe Z. Helwig Überacker.

Zyra e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga Dëshmorët e 4 Shkurtit, Pallati 5, Kati 5, Ap3, Tiranë.

Shoqëria është regjistruar si një subjekt i tatueshëm në zyrën e taksve të rrethit të Tiranës me numer NIPT-i K82412002S. Numri i punonjësve të shoqërisë më 31 dhjetor 2008 është 1.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Këto standarde janë të aplikueshme për raportimet financiare që fillojnë më 1 janar 2008.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga ai i parashikuar.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse shpjeguese të pasqyrave financiare. Në periudhën aktuale përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal, duke konsideruar thjeshtësinë e veprimtarisë së Shoqërisë.

DEVOLL HYDROPOWER SH.A

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 18 dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 dhjetor 2008

(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar për periudhën që fillon më 18 dhjetor 2008.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejta dhe detyrimet jo-monetare të paraqitura në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozita afat me afat maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

DEVOLL HYDROPOWER SH.A

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 18 dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 dhjetor 2008

(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIMI)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdimi)

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale. Aksionet e preferuara të detyrueshme me të drejtë riblerjeje klasifikohen si detyrime.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten në “Ndërtim në proces” dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet zhvlerësimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjitha aktivet afatgjata jomateriale dhe me vlerën e mbetur për të gjitha aktivet afatgjata materiale, mbi jetën e vlerësuar të cdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

DEVOLL HYDROPOWER SH.A

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 18 dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 dhjetor 2008

(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT BAZË KONTABËL (VAZHDIMI)

3.4 Zhvlerësimi

i Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatim fitimi

Shpenzime tatim fitimi përfshijnë shpenzimin e vitit përfshirë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatim fitimi është detyrimi i pritshëm mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normën e tatimit në fuqi për periudhën.

DEVOLL HYDROPOWER SH.A**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për periudhën nga 18 dhjetori 2008 (data e fillimit) deri më 31 dhjetor 2008***(të gjitha shumat janë në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***4. MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE**

	31 dhjetor 2008
Mjete monetare dhe ekuivalente	<u>2,049,670</u>
Totali	<u>2,049,670</u>

Më 31 dhjetor 2008 shoqëria ka hapur një llogari bankare në Raiffeisen Bank, e cila ka një gjendje prej EUR 16,556.3, e cila e vlerësuar me kursin e fund vitit tregon një vlerë prej 2,049,670 LEK.

5. KAPITALI

Bazuar në dokumentat e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, datë 18 dhjetor 2008, kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 2,000,000 Lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1,000,000 kuota secili me vlerë nominale prej 2 LEK, që zotërohet 50% nga EVN AG Austria dhe 50% nga Statkraft AS Norway.

6. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Nuk ka pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta më 31 dhjetor 2008.